

Procesverbal

Konsultim publik: Takim me banoret e bashkise Dropull

Data: 23.06.2022 **Ora:** 11:00 **Vendi:** Salla e mbeldhjeve te Keshillit Bashkiak Dropull,

Numri i pjesemarrësve: totali :26 ,gra: 12,burra: 14

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Projekt dokumenti i pare PBA 2023-2025, te Bashkise Dropull

Pjesëmarrës : Janë prezent: Kryetari i Bashkisë z.Dhimitraq Toli,Drejtuesit e Drejtorive të Bashkisë, znj.Thalia Pulla, nenkryetar ekonomik z.Panajot Dhefto, z.Arjan Tusha , znj. Lindita Xhumba,z.Llambi Ngjelo,z.Kristaq Lengo,znj.Aleksandra Ferro dhe punonjes nga administrata ,Këshilltarë të Këshillit Bashkiak; qytetarë; pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media .

Takimi drejtohet nga Nenkryetari i Keshillit bashkiak Z. Dhimitri Koça, i cili hapi takimin duke u ndalur ne: ♠ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik ♠ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit ♠ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës. ♠ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Ne fjalën e tij ne lidhje me projektdraftin e PBA-se 2023-2025 te bashkise Dropull, Kryetari i Bashkise Z. Dhimitraq Toli u ndal ne sa me poshte: ♠ Ky takim është një takim në vazhden e shumë takimeve konsultuese që Bashkia e Dropull do te realizoje dhe në të gjitha Njësitë Administrative, kërkesat dhe vërejtjet që do te prezantohen nga banorët, apo nga gjëra që janë reflektuar nga vetë Bashkia.,sipas mundesive do te merren parasysh ne hartimin e tavaneve pergatitore

Fjalën e merr drejtoresha e deges te buxhetit znj.Thalia Pulla:E cila ben prezantimin e projektdokumentit te pare te PBA-se te vitit 2023-2025 permes monitorit.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon : **Z. Spiro Basho**,perfaqesues nga komuniteti ,sjell shqetesimin e nje numri te konsiderueshem banorësh qe konsiston ne:situatën e banorëve të larguar nga njësitë administrative,sidomos te rinjte qe po largohen,duke kerkuar me shume vemendje nga bashkia per te rinjte.Kerkoj pyes nëse ka parashikuar kjo paketë diçka për ta? Gjithashtu kerkoj me shume vemendje per rrugicat e fshatrave,duke qene prift i kesaj bashkie shkoj ne te gjitha fshatrat dhe degjoj te gjitha ankesat dhe kerkesat e banoreve lidhur me pastrimin e fshatrave me restaurimin e rrugeve, pastrimin e varrezave.

Fjalën e merr kryetari i Bashkise z.Dhimitraq Toli: Lidhur me shqetesimet qe ngriti z.Basho,ne buxhetin e bashkise kemi parashikuar fond per pastrimin dhe resaturimin e rrugicave qe jane problematike ne bashki,kemi marre dhe nje makine te vogel per te shkuar fshat me fshat ne

menyre qe te mbledhim pleherat dhe ne ato fshatra ku terreni eshte mjaft i thyer per te shkuar makina.

Nenkryetari i keshillit tha: Duke qene se kemi marre shume ankesa nga banoret per transportin publik ne fshatrat e larget,pyes nese eshte parshikuar nga ana juaj nje zgjidhje per transportin e ebanoreve te njesise administrative dropulli I siperm.

Pergjigjet Kryetari i Bashkise:Duke filluar nga Dita e Hene autobuzi i bashkise, 2 here ne jave e Hene dhe e Enjte, do beje transportin e e udhetareve nga fshatrat me te largeta ne Qendren e Bashkise dhe anasjalltas.

Z. Kristo Varsami,keshilltare, ngre shqetesim dhe qe bimet medicinale te ruhen dhe te mosçrrejosen,pasi kemi pare shume makina qe i mbledhin keto bime ne malet e fshatrave tona .

Pergjigjet kryetari i Bashkise;I le per detyre punonjeseve te policies te bashkise te bashkepunojne me kryetaret e fshatrave per kete problematik,qe per mbledhesit pa leje te kete sanksione.

Fjalën e merr Dhimitri Koça:Kerkoj nga ana e administrates te hartoj nje plan menaxhimi per Pyjet dhe Kullotat,pasi ne kete menyre mund te marrim fond nga qeveria per projekte.ne kete sektor.

Pergjigjet znj.Thalia Pulla:Ne projekt dokumentin 2023-2025, per vitin 2022 kishim ne program blerje mjet germimi,meqenese do na dhurojue nga Greqia ,vendosem te bejme trasferim te ketij fondi per hartimin e nje plani 10 vjecar te mbareshtimit te pyejeve dhe kullotave.

Sekretare

Urania Kuremeno

